



“INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE” (I.R.SH)
“YOUNG INTELLECTUALS, HOPE” (“YIH”)
L:”QEMAL STAFA”, RR:”DAUT BORIÇI”, NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com
Date 19 Prill 2017

LETET E HAPUR

Drejtuar: *z.Xhemal Bushati, Kryetar i Keshillit Bashkiak Shkoder*
Anetareve te Keshillit Bashkiak Shkoder

Shoqata “*Intelektualet e rinj, Shprese*” ne kuader te projektit “*Behu Aktiv, Nderto te Ardhen*” te mbeshtetur nga **Olof Palme International Center** nepermjet financimit te **Qeverise Suedeze**, qe ne muajin Maj 2016, ne kuader te monitorimit te transparences ne Bashine Shkoder ka ndermarre monitorimin e aktivitetit te shoqerise “**KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA**” sh.a.

Ne Nentore te vitit 2016 eshte publikuar raporti mbi kete shoqeri e cila shpenzon shuma te konsiderueshme te parave publike te taksapaguesve shkodrane dhe nga monitorimi rezultoi se gjindej ne kushtet e falimentit prandaj u rekomandua auditimi i shoqerise nga Kontrolli i Larte i Shtetit si dhe te fillonte menjehere procedura e privatizimit!

Duke marr shkas nga gjetjet e raportit te KLSHse ne baze te nenit 19, ligji Nr. 139/2015 “*Per vetqeverisjen vendore*”, shoqata “*Intelektualet e rinj, Shprese*” me ane te kesaj kerkese Ju drejton nje thirrje te hapur qe me nje fryme te larte pergjegjesie ndaj qytetareve shkodrane te merrni ne analize situaten e krijuar nder vite ne shoqerine “**KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA**” sh.a.

Kjo shoqeri e cila financohet nga taksapaguesit shkodrane, sipas auditit me te fundit te Kontrollit te Lartet e Shtetit ka rezultuar:

- a) *me nje siguri mjaft te ulet te nivelit te menaxhimit te fondeve publike,*
- b) *mos funksionim total te organeve kryesore drejtuese*
- c) *aktiviteti i saj zhvillohet me nje mungese te theksuar te transparences!*

Si rezultat i ketij menaxhimi te dobet financiare dhe administrativ bilancet e shoqerise qe nga krijimi i saj dhe deri ne ditet e sotme kane rezultuar me kapital negativ dhe asnjehere nuk ka patur nje analize serioze per te ndertuar programe te qendrushme financiare te cilat duhet te reduktojne humbjet per ta kthyer shoqerine ne funksion te qellimit per te cilin eshte krijuar dhe duke garantuar qytetaret shkodrane ne menaxhimin sa me te mire te fondeve publike!

Si rezultat i kesaj gjendje alarmante shoqeria ka plotesuar te gjitha kushtet ligjore per te shkuar drejt falimentimit, fakt ky i paralajmeruar prej vitesh nga eksperti kontabel i shoqerise, si dhe nga te gjitha raportet e fundit!

Duke qene se jemi informuar se me daten 20 Prill 2017 zhvillohet mbledhja e Asamblese te shoqerise "KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a. fatkeqesisht konstatojme se rend i dites nuk ka parashikuar asnje pike ku:

- 1) *Te prezantohet nje raport vjetore per te bere te mundur informimin e situates aktuale te klubit te Futbollit si ate financiare, teknike dhe organizative!*
- 2) *Te analizohen pergjegjesite si dhe te miratohet nje sistem i pershtatshem dhe efektiv i menaxhimit dhe i kontrollit*
- 3) *Te diskutohen mbi hapat konkret per realizimin ne menyre sa me te shpejte dhe efektiv te procesit te privatizimit*

Persa mesiper dhe duke ju percjellur edhe disa prej gjetjeve kryesore te ngritura nga Raporti i Kontrollit te Larte te Shtetit si dhe duke u nisur nga shqetesimi i vazhdueshem qytetare:

Ju bejme thirrje qe duke analizuar me pergjegjesi te plote situaten aktuale te ndermerrni hapa te pershpejtuara dhe konkrete per privatizimin e shoqerise "KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a. duke informuar ne menyre te vazhdueshme publikun mbi ecurine e ketij procesi!



Singerisht

Saimir Beqiraga
President i IRSH

Raport permbledhes

mbi gjetjet e KLSHse mbi Auditimin ne shoqerine “KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA” sh.a per periudhen Janar 2014-Dhjetor 2016

Publikuar, Mars 2017

Ne fokus te auditimit kane qene:

- 1) Siguria e nivelit te menaxhimit

- 2) Transparenca

Gjetje:

A. Ne lidhje me piken e pare “Siguria e nivelit te menaxhimit” eshte konstatuar nje performance e dobet ku konstatohen dy probleme kryesore (fq 3):

- a) Ulje e te ardhurave
- b) rritje e shpenzimeve

Jane identifikuar si shkelje:

- 1) Shperblimet nuk jane kryer me miratimin e Asamblese (fq 49)
- 2) Nuk jane zhvilluar asnjehere procedura prokurimesh (fq 49)
- 3) Mungojne Programet financiare
- 4) Mungon Dokumentimi veprimeve financiare
- 5) Mos miratimi i pasqyrave financiare ne Asamble dhe mos dorezimi i tyre ka sjell qe shoqeria eshte gjobitur me gjobe nga OKR ne zbatim te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Per qendren kombetare te regjistrimit” ne shumen 30.000 leke sipas urdhershpenzimit te dates 21.12.2014 dhe te dates 01.07.2015.
- 6) Lojtaret jane trajtuar me kontrata sherbimi duke mos u llogaritur dhe derdhur sigurimet shoqerore e shendetore.
- 7) Per sezonin 2015-2016 Jane paguar 32 lojtare nga 25 qe eshte numri lejuar i FSHF
- 8) Per sezonin 2016-2017 Jane paguar 28 lojtare nga 25 qe eshte numri lejuar i FSHF
- 9) Nuk ka ngritur dhe miratuar nje sistem te pershtatshem dhe efektiv te menaxhimit dhe te kontrollit
- 10) Nuk eshte hartuar Deklarata e Vizionit dhe Misionit te shoqerise ku te jene te percaktuara objektivat afatgjate per shoqerine.
- 11) Nuk ka nje kuptim te qarte te menaxhimit te riskut, pasi nuk ka te miratuar strategji te riskut apo identifikim te tij sipas nenit 21 te ligjit nr.10296, date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 12) Nuk eshte hartuar regjistri i riskut bazuar ne objektivat e shoqerise duke vepruar ne kundersizim me nenin 11, 20, 21 te ligjit nr.10296, date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”
- 13) Transaksionet financiare jane me mungesa te theksuara te dokumentave te bashkangjitur ligjore.
- 14) Jane lidhur 13 kontrata qiraje ne kundersizim me dispozitat e Kodit Civil si dhe pa procedure konkurrese (fq 21-22)
- 15) Sipas pikes 1 te nenit 148 te Rregullores se Veprimtarise Futbollistike te FSHF nuk eshte dorezuar plani financiar brenda dates 31 Mars (fq 29)

16) 1.2% e shpenzimeve i perkasin lendeve djegese nderkohe qe shoqeria nuk ka asnje mjet transporti ne inventar.

17) Shpenzimet e kryera per blerje mallrash, sherbimesh etj jane kryer pa zbatuar procedura prokurimi ne kundershtim me rregullat e percaktuara ne nenin 1, neni 3/pika 4 germa ç te nr.9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” (fq 47)

18) Detyrimi i shoqerise:

a) per sigurime shoqerore e shendetsores per lojtaret e treneret referuar kontratave te lidhura eshte ne shumen 35.652.852 Leke. (fq 6)

b) 15% i tatimit ne burim ne shumen prej 23.192.366 leke i mbajtur sipas kontratave te lidhura me lojtaret dhe stafin sportiv nuk eshte kontabilizuar dhe nuk eshte derdhur ne Degen e Tatimeve Shkoder ne zbatim te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” dhe te ligjit 8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”

B) Ne lidhje me piken e dyte “Transparenca” eshte konstatuar se:

1. Ne kundershtim edhe me ligjin nr.119/2014 “Per te drejten e informimit” por gjithashtu edhe me nenin 15 te ligjin nr.9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, nga ana e shoqerise nuk eshte publikuar asnje e dhene per aktivitetin e saj, detyrim qe duhet te permbushet duke e vendosur kete informacion ne faqen e internetit te shoqerise tregtare duke informuar per kete personat te cilet e bejne kerkesen. (faqe 5)

2. Nuk rezulton te jete hartuar dhe miratuar nje rregullore e brendshme per organizimin dhe funksionimin, detyrat dhe pergjegjesite e administrates se shoqerise, ku te jete percaktuar struktura organizative dhe detyrat funksionale per çdo drejtori, punonjes te saj ne menyre qe organizimi i burimeve ne dispozicion, caktimi i pergjegjesive, ndarja e detyrave dhe linjat e raportimit te jete e tille duke respektuar parimet e transparences ne administrim (fq 7)

3. Ne shoqeri nuk eshte ngritur nje sistem monitorimi (fq 7)

4. Vendimet per aktivitetin e shoqerise jane marre nga administratoret. Nga ana e tyre nuk jane kryer raportime periodike dhe vjetore per te bere te mundur informimin e situates aktuale te klubit te Futbollit si ate financiare, teknike dhe organizative (fq 7)

5. Dokumentacioni kontabel nga shoqeria eshte administruar nga specialisti i finances per periudhen 4-vjeçare dhe nuk eshte dorezuar ne arkiv mbeshtetur ne dispozitat ligjore.

6. Nuk jane publikuar kopjet e procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese nga ana e administratorit ne kundershtim edhe me nenin 16 te statutit te shoqerise.

7. Mungon informacioni per ecurine e shoqerise tregtare ku duhet te vihen ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo eksperteve kontabel te autorizuar si dhe çdo dokument tjeter te brendshem te shoqerise.(fq 20)

8. Moskryerja e procedurave te prokurimit nga shoqeria, ka çuar ne shkeljen e parimeve te prokurimit te cilat sigurojne dhe garantojne mireperdorimin e fondeve publike, nxitjen e konkurences dhe transparencen e procesit.

1. Analizimi i aktivitetit të Organetive të shoqërisë:

1. Asambleja

1. Asambleja funksionale (fq 4) ku vendimet për shtim kapitali janë marrë pa një relacion shpjegues të Keshillit Mbikqyres. Ka vetëm dy lloj vendimesh:

a) Vendim për shtim kapitali

b) Vendime për emerim apo shkarkim të Keshillave Mbikqyres

2. Vendimet e Asamblese nuk rezultojnë të rregjistruara në një regjistër të posaçëm në kundërshtim me nenin 135, pikë 4 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

3. Nuk janë përcaktuar politikat tregtare të KF. "Vllaznia" sh.a

4. Vendimet e Asamblese së Përgjithshme për shtim kapitali janë marrë pa u paraqitur relacione të hartuara nga ana e Keshillit Mbikqyres për buxhetin e shoqërisë, në kundërshtim me nenin 135, pikë 3 e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

*5. Asambleja nuk ka ushtruar funksionin e saj në funksion të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", duke qenë se ky organ ka të drejtat e pronarit në KF. Vllaznia sh.a. në kundërshtim me nenin 9 pikë 12, shkronja c) të Ligjit 139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore" ku përcaktohet se: **"e drejta e pronësisë ushtrohet nga keshilli përkatës i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kesaj të drejte askujt tjetër"** (fq 14)*

6. Asambleja e përgjithshme nuk ka kryer verifikimet nëse anëtarët e Keshillit Mbikqyres plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

2. Administratori dhe Keshilli Mbikqyres:

1. Emerimi i anëtarëve të Keshillit Mbikqyres rezultojnë me shkelje dhe mangësi dokumentacioni

*2. Nga ana e Keshillit Mbikqyres i cili luan rol monitorues në shoqëri rezultojnë se për periudhën objekt auditimi **ka qenë inekzistent** (faqe 7)*

*3. Procesverbalet e mbledhjeve nuk nënshkruhen nga anëtarët si dhe nuk protokollohen **rrjedhimisht janë të pavlefshme dhe le vend për abuzime nga ana e organeve të shoqërisë** (fq 18)*

*4. **Ka marrë vendime jashtë kompetencave të tij** (në kundërshtim me pikën 1, germa c të nenit 167 Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".*

*Konkretisht Vendimi nr.2, datë 08.01.2016 i Keshillit Mbikqyres ka miratuar strukturën bashkë me pagat dhe pas kësaj miratimi, relacioni apo propozimi nuk ka kaluar për miratim në Asamblenë e Përgjithshme, duke dalë jashtë kompetencave që ai ka si organ **dhe aktet e dala jashtë kompetencave të organit janë akte absolutisht të pavlefshme** bazuar në ligjin nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" (fq 4)*

*5. **Vendimi nr.2, datë 08.01.2016 i Keshillit Mbikqyres është i bazuar tek një VKM nr.165, datë 02.03.2016 i cili ka dalë rreth dy muaj me vonë!!!***

*6. Në shoqëri **nuk gjendet ndonjë udhëzim për përgatitjen e programeve ekonomiko-financiare** ku të përcaktohet struktura e shpenzimeve sipas objektivave të shoqërisë, afatet e përgatitjes së tyre, afatet për miratimin e këtyre programeve financiare si në Keshillin Mbikqyres dhe në Asamble **veprim i cili ngarkon me përgjegjësi ish titullarët dhe titullarin aktual dhe Keshillat Mbikqyres të cilat nuk kanë ushtruar rolin e mbikqyres së shoqërisë.** (faqe 5)*

*7. **Nuk është hartuar dhe ndjekur një plan të ardhurash sipas burimeve të krijimit të tyre.***

8. Nuk ka dalë ndonjë vendim i Keshillimit Mbikqyres për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të administratës dhe punonjësve të tjerë të shoqërive tregtare sikurse është VKM nr.412, datë 27.06.2012 "Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të

keshillave, bordeve ise komisioneve” organe keto mbikqyrese te shoqerive tregtare aksionere.

9.Nuk jane paraqitur relacione te hartuara nga ana e Keshillit Mbikqyres per buxhetin e shoqerise, ne kundershkrim me nenin 135, pika 3 e Ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “**Per tregtaret dhe shoqerite tregtare**”

10.Asnje nga anetaret e Keshillit Mbikqyres per vitin 2014, 2015, 2016 nuk ka depozituar dokumentacionin qe verteton se nuk eshte emeruar ne shkelje te pikes 3 te nenit 167 te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

11. Nuk ka respektuar nenin 22 te statutit per miratimin e nje rregulloreje e cila te percaktoje procedure e funksionimit te Keshillit Mbikqyres.

10. Me vendimin nr.9, date 02.03.2016 Keshilli Mbikqyres ka miratuar “**Deklaraten e Miradministrimit” ne deklaraten e miratuar ka mosperputhje lidhur me respektimin e qellimit qe i ka dhene Ligji deklarates se mireadministrimit ku nuk eshte shpjeguar arsyeja qe anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te kualifikuar per te qene pjese te ketij organi apo nuk ka nje profil te administratoreve!!!**

11.Nuk eshte respektuar neni 30 i statutit ku percaktohet se:”**Administratoret duhet te informojne menjehere Kryetarin e Keshillit Mbikqyres ne rastet kur: Sipas bilancit vjetore apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton apo parashikohet se humbjet arrijne ne nje vlere te barabarte me 50% te kapitalit ose qe aktivet e shoqerise nuk mbulojne detyrime qe jane te kerkueshme brenda 3 muajve ne vijim**” (fq 20-21)

12.**Ne urdherin e brendshem nr.2, date 24.01.2016 e leshuar nga Administratori personi i kontraktuar si magazinier urdherohet te kryej detyren e juristit per lidhje e kontratave te qirase! (fq 23)**

13.Kontraktimi i punonjesve eshte hartuar pa plan apo numer te percaktuar si dhe nuk ka asnje dokument qe percakton sesa duhet te jete numri i punonjesve administrativ. Sipas rregullores se FSHF Klubi i Futbollit eshte i detyruar te punesoje:

- 1) Sekretarin e Klubit (i cili nuk ekziston)
- 2) Oficerin e sigurise (i cili nuk ekziston)
- 3) Zedhenesin e shtypit
- 4) Financierin

14.Mungon baza ligjore e detajuar ne kontrata, mungon pershkrimi i punes etj (fq 25)

15.Nuk eshte miratuar buxheti i shoqerise ne Asamble/Keshillin Bashkiak

16.Per te gjitha periudhen e auditimit nuk eshte bere analize per realizimin e te ardhurave dhe te shpenzimeve si dhe nuk eshte informuar Asambleja te pakten nje here ne vit per te nxjerr pegjegjesite dhe masat qe duheshin marre per permiresimin e punes (fq 34)

17.Nuk eshte ngritur dhe miratuar nje sistem i pershtatshem dhe efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit ne zbatim te nenit 8, te Ligjit nr.10296, date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” (fq 69)

2.Ligjet te cilat nuk jane zbatuar:

- 1.Ligji nr.9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
- 2.Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative ne Republikën e Shqiperise”
- 3.Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e informimit”
- 4.Ligji 7961, date 12.07.1995 “Kodi i punes”
5. Ligji nr.9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise”
6. Ligji nr. 8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”
- 7.Ligji nr.9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”
- 8.Ligji nr.10296, date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”
9. Ligji nr.9154, date 06.11.2013 “Per arkivat”
- 10.Ligji nr.9743, date 03.05.2007 “Per regjistrimin e biznesit”
- 11.Ligji 139/2015 per “Vetqeverisjen Vendore”
- 12.Ligji nr.7850, date 29.07.1994 “Kodi Civil te RSH”
13. Ligji nr.10405, date 24.03.2011 “Per kompetencat per caktimin e pagave dhe te shperblimeve”
14. Ligji 9228, date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- 15.Ligji nr.8379, date 29.07.1998 “Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit te Republikës se Shqiperise”
- 16.Ligji nr.9959, date 17.07.2008 “Per te huajt”
- 17.Ligji 7703 date 11.05.1993 “Per sigurimet shoqerore ne Republikën e Shqiperise”
- 18.Ligji 9723, date 03.05.2007 “Per qendren kombetare te regjistrimit”

3.Vendimet e Keshillit te Ministrave (VKM) te cilat nuk jane zbatuar

1. Nr.1114 date 30.07.2008 “Per disa ceshtje ne zbatim te ligjeve nr.7703, date 11.05.1993 “Per sigurimet shoqerore”, ligjit 9136, date 11.09.2003, i ndryshuar “Per mbledhjen e kontributeve” te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore
2. Nr.271, date 09.05.1998 “Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shtetere”
3. Nr.1718, date 24.12.2008
4. Nr.412 date 27.06.2012 “Per caktimin e mases se shperblimit te anetareve te Keshillave bordeve ose komisioneve”
5. Nr.478, date 16.06.2010
6. VKM nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”

4.UDHEZIME te cilat nuk jane zbatuar:

1. Udhezimi nr.30 date 27.12.2011 i Ministrise se Financave “Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik”
2. Udhezimi i Ministrise Financave nr.2 date 06.02.2012, “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”
3. Udhezimi i APP nr.3, date 27.01.2015 “Per procedurat e prokurimit me vlere te vogla”
4. Udhezimi i APP nr.5, date 27.01.2015 “Per procedurat e prokurimit me vlere te vogla ne sistemin elektronik”

5.Rregullore te cilat nuk jane zbatuar:

1. Rregullore e Veprimtarise Futbollistike te FSHF

6.PROPOZIMET nga Raporti i KLSHse:

A.Te menjehershme (fq 72-75):

1. **Shoqeria te kontabilizoje** dhe te marre masa **qe detyrimi ne shumen prej 23.192.366 leke**, per tatimin nga te ardhurat nga punesimi i mbajtur ne masen prej 15% per lojtaret e ekipit te pare per periudhen objekt auditimi, referuar kontratave te lojtareve **te derdhet ne Degen e Tatimeve Shkoder.** (fq 75)
2. Shoqeria te marre masa per trajtim financiar te kujdesshem te arketimeve te kryera nga Federata Shqiptare e Futbollit **permes dokumentimit te te ardhures se perfutuar dhe specifikim te destinacionit te perdorimit te hyrjeve ne para.**
3. Nga shoqeria te merren masa te menjehershme qe per aktivitetin qe kryejne lojtaret e futbollit te ekipit te pare dhe per te gjithë stafin sportiv te skuadres per lidhjen e kontratave te punes te lojtareve si dhe **perfshirjen e tyre ne skemen e sigurimeve shoqerore** ne zbatim te Ligjit 7961, date 12.07.1995 “Kodi i punes” dhe Ligjit 7703 date 11.05.1993 “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise”
4. Kontratat e lojtareve te ekipit te pare **te plotesohen sipas kerkesave te nenit nr.36 te Rregullores se Federates Shqiptare te Futbollit**
5. Shoqeria te marre masa qe **perzgjedhja e lojtareve te ekipit te pare te behet sipas kerkesave te rregullores se FSHF pasi te dokumentohet me nje raport teknik te perpiluar nga specialiste te fushes ne perberje te bordit te perzgjedhjes se lojtareve,** raport qe duhet te miratohet ne Keshillin Mbikqyres
6. Kontrata duhet te shprehet qarte per menyren jo vetem te financimit te sigurimit shendetsor apo te jetes por edhe dokumentimi i ketij shpenzimi.
7. Shoqeria te lidhe kontrate apo marreveshje me Bashkine Shkoder duke percaktuar statusin juridik te ambientit qe ka ne perdorim dhe te fushes se futbollit.
8. Ne bashkpunim me Bashkine Shkoder te merren masa per permiresimin e ambjenteve te magazinimit.
9. Te merren masa nga shoqeria per nenshkrimin e procesverbaleve nga Keshilli Mbikqyres dhe te evidentoj pasqyrimin e tyre ne regjistrin e vendimeve dhe te sekretohen nga zyra e protokollit te Klubit te Futbollit Vllaznia sh.a. sipas dispozitave ligjore.

B. Brenda muajit Mars 2017: (fq 74):

1. Shoqeria duhet te percaktoje sipas listes se lojtareve, kohes se qendrimit ne sezon ndeshje numrin e kontratave per qira banese, afatin kohore, personin qe do ta perdore, çertifikaten e pronesise, ne zbatim te kerkesave ligjore ne fuqi

C. Brenda muajit Prill 2017: Nga Keshilli Mbikqyres te merren masa qe (fq 71-75):

1. Te gjitha procedurat e blerjeve per mallra/sherbime te realizohen permes procedurave te prokurimit publik duke synuar nje efektivitet te shtuar ne realizimin e ketyre blerjeve
2. Te kete nivele tavan shpenzimesh te miratuara nnga Keshilli Mbikqyres sidomos lidhur me shpenzimet e akomodimit, ushqimi per sportistat, shpenzimet e transportit per te mbajtur nivele te kontrolluara te shpenzimeve por duke mos demtuar trajtimin e ketyre sportisteve.

3. Procesi i hartimit te projekt programeve ekonomiko-financiare te mos jete proces formal dhe te realizohet ne funksion te plotesimit te objektivave strategjike dhe vjetore te Klubit Vllaznia sh.a.
4. Programimi i sakte sipas burimeve te te ardhurave dhe shpenzimeve te shoqerohet me relacionet perkatese per ta miratuar ne Keshillin Mbikqyres brenda afateve te percaktuara ne bazen rregullative
5. Te merren masa te menjehershme per miratimin e nje rregulloreje funksionimi te shoqerise ku te behet organizimi i burimeve ne dispozicion, caktimin e pergjegjesive, ndarja e detyrave si dhe linja e raportimit dhe llogaridhenies, sipas nje sistemi efektiv kontrolli vertikal dhe horizontal.
6. Struktura dhe masa e shperblimit te pagave te miratohet ne Keshillin Bashkiak
7. Shoqeria te marre masa qe te hartoj regjistrin e riskut ne menyre qe te identifikohen risqet qe kercenojne realizimin e objektivave.

D.Brenda muajit Maj 2017: (fq 73):

1. Shoqeria te marre masa qe te pasqyroje ne kontabilitet dhe pasqyrat financiare, vleren e logos se Klubit te Futbollit ne shumen prej 63.900.000 leke, ne zbatim te ligjit nr. 9228, date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
2. Te behet nje analize e kujdesshme e niveleve te larta te humbjes dhe te merren masa per permiresimin e gjendjes financiare, analize qe duhet te shoqeroje miratimin e rezultatit financiar ne Keshillin Bashkiak (Asamble)

E. Te tjera: (fq 75)

1. Per shkeljet e konstatuara dhe trajtuar rast pas rasti ne Raportin Perfundimtare te Auditimit, bazuar ne nenin 154 pika 1 shkronja f dhe i, nenin 158 pika 7 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, nenin 37 te ligjit 7961, date 12.07.1995 “Kodi i punes” dhe neni 9 i kontrates individuale te punesimit, i rekomandojm Drejtorit te Shoqerise (Administratorit) dhe Keshillit Mbikqyres te analizoje pergjegjesite dhe ndaj personave perkates ne raport me shkeljet e konstatuara te marre masat e nevojshme disiplinore.
2. Per eliminimin e mangesive dhe permiresimin e punes per te ardhmen Administratori i shoqerise te hartoje plan veprimin me persona pergjegjes dhe me afate konkrete.